



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 19/ prot.
13

Tiranë, më 18.01.2018

V e n d i m

Nr. 1, datë 18 janar 2018

Për aprovimin e përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave në Komisionin e përbashkët të Mirëbesimit mes MASR dhe ASH-së dhe për një ndryshim në numrin dhe përbërjen e Komisionit Ad Hoc.

Drejtuar: Komisionit të përbashkët të mirëbesimit MASR-ASH;
Këshillit Ekzekutiv
Komisionit *ad hoc*;
Anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
Sektorit të Financës;
Sektorit të Personelit.

Për dijeni: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Mbështetur:

1. Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, "*Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*", neni 4, pika c, i ndryshuar;
2. Statutit të Akademisë së Shkencave, neni 2, pika 10 dhe 12;

Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të zakonshme të datës 18 janar 2018, me rend dite (bashkëmbyllur) të bërë publik më datën 15 janar 2018, mbështetur shkresës nr. prot 224, datë, 10.01.2018 "*Për vijimin e ristrukturimit të Akademisë së Shkencave*", të Ministres së Arsimit (bashkëmbyllur), drejtuar kryesisë së ASH-së ku kërkohet caktimi i dy përfaqësuesve të ASH-së në Komisionin e Përbashkët të Mirëbesimit, si dhe propozimit të akademik Apollon Baçe, kryetar i Komisionit Ad Hoc të reformës (bashkëmbyllur), ku kërkohet zëvendësimi i dy anëtarëve të dorëhequr të këtij komisioni, pas arritjes së kuorumit dhe aprovimit të rendit të ditës, me propozime të drejtpërdrejta të anëtarëve të Asamblesë (shih procesverbalin) dhe me votim të hapur;

Vendosi:

1. Akademik Vasil S. Tole, sekretar shkencor i ASH-së dhe akademik Beqir Meta të jenë përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave në përbërje të Komisionin të përbashkët të Mirëbesimit mes MASR dhe ASH-së, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit.
2. Në vendim e asamblesë nr. 18 datë 11 shtator 2017 *“Për krijimin e komisionit ad hoc, me mandat të plotë përfaqësirni, miratuar nga Asambleja e Akademisë së Shkencave, për reformën në kërkimin shkencor dhe në atë institucionale”*, pika 2, të ndryshojë si më poshtë:

Komisioni Ad Hoc të ketë 9 anëtarë akademikë me këtë përbërje:

Akad. Apollon Baçe, anëtar i asamblesë;
Akad. Artan Fuga, anëtar i asamblesë;
Akad. Anastas Angjeli, anëtar i asamblesë;
Akad. Aurela Anastasi, anëtar i asamblesë;
Akad. Floran Vila, anëtar i asamblesë;
Akad. Kosta Barjaba, anëtar i asamblesë;
Akad. Neki Frashëri, anëtar i asamblesë;
Akad. Skënder Gjinushi, anëtar i asamblesë;
Akad. Salvator Bushati, kryetar i seksionit të shkencave natyrore e teknike;

3. Të falenderojë për mbështetjen dhe bashkëpunimin në procesin e reformës, akademinë e shkencave të Gjermanisë-LEOPOLDINA dhe ALLEA-n.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen seksionet gjegjëse shkencore të Akademisë së Shkencave dhe nënstrukturat e tjera të saj, përmendur në krye të këtij vendimi.
5. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.
6. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar Shkencor

Vasil S. Tole

